



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

VENDIM

Nr. 84, datë 13 . 11 .2020

“PËR

LEJIMIN E KANDIDIMIT TË ZOTIT GENTIAN METE NË VENDIN VAKANT
PËR INSPEKTOR JO MAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I
DREJTËSISË NË DATËN 07.02.2020”.

KOMITETI I EMËRIMIT EDHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE i përbërë nga :

Artur Metani - Kryetar
Mirela Kapo - Anëtare
Marsela Pepi- Anëtare

Asistuar nga sekretare Adela Skora,

në mbledhjen e datës 30 . 10 .2020, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

INSPEKTOR JO MAGJISTRAT

Zoti GENTIAN METE

OBJEKTI:

Urdhërimi i lejimit të kandidimit të zotit
GENTIAN METE, në vendin vakant për
Inspektor jo magjistrat, të shpallur nga
Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën
07.02.2020.

KOMITETI PASI :

U njoh me aktet si edhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në datë 07.02.2020, ka vendosur fillimin e procedurës përzgjedhëse të kandidatëve jomagjistratë që kanë shprehur interes për pozicionin e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant për Inspektor jo magjistratë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është edhe zoti GENTIAN METE.

4. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 209 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të gërmës A, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbledhjen e zhvilluar në datën 07.02.2020, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

5. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 209 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të pikës 27, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019,

2

të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas administrimit të të gjithë dokumentacioni, në mbledhjen e zhvilluar në datën 30.10.2020, është realizuar dhe rradha e shqyrtimit të dosjes që i përket çdo kandidati.

6. Zoti GENTIAN METE, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me kërkesën me nr.prot 415, në datën 02.03.2020 ka shprehur interes për pozicionin e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Rrjedhimisht, nisur dhe nga detyrimet ligjore, kandidati, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

7. Në datën 28.04.2020, kandidati GENTIAN METE, është paraqitur pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

8. Në datën 14.05.2020, kandidati GENTIAN METE ka depozituar në sekretarinë e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

9. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe **kontrollin e pasurisë**, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin

e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, si edhe në zbatim të seksionit A, të Kreut IV, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, me shkresën përcjellëse me nr. Prot.630 datë 04.05.2020, i ka dërguar Inspektorit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë (I.L.D.K.P.K.I), listën e kandidatëve dhe të personave të lidhur me ta, sikurse janë deklaruar prej vetë kandidatëve, që i nënshtrohen procedurës së deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, si edhe kopjet e deklaratave të nënshkruara nga secili prej tyre .

10. Me shkresën nr. 630 datë 04.05.2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, ligjit nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së Drejtësisë” .

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati GENTIAN METE, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr.1943/11 prot, datë 29.07.2020, I.L.D.K.P.K.I ka informuar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë se kandidati GENTIAN METE, e ka përmbushur detyrimin për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. I.L.D.K.P.K.I, në zbatim të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, me shkresën nr. 1943/11 prot., datë 29.07.2020, ka dërguar pranë zyrës së Inspektorit të Lartë në Drejtësi, rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin GENTIAN METE dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, si dhe në zbatim të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve

për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, me shkresën me nr. Prot.1942/2 datë 26.05.2020 nga ana e I.L.D.K.P.K.I njoftohemi se ky institucion kryen verifikime. Konkretisht administron, analizon si dhe kryen veprime verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit GENTIAN METE dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit GENTIAN METE, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i është drejtuar me kërkesa për informacion I.L.D.K.P.K.I-së lidhur me institucionet financiare me të cilat ky institucion ka korrespondencë dhe administron përgjigjet e tyre . Evidentohet se ky institucion kërkon informacion në funksion të kontrollit të plotë:

a) Institucioneve bankare: Banka e Shqipërisë, Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Intesa Sanpaolo, Banka Alpha Albania, Banka Tirana, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka Procredit, Banka e Parë e Investimeve, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Credins, Banka Union, Banka OTP Albania, Raiffeisen Leasing , Porsche Leasing, RFZ Invest sh.a, Credins Invest sh.a, ASHK, DPSH TRR, Qendra Kombëtare e Biznesit, DPT, ISSH, D.P Detare.

16. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, **lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit**, në zbatim të nenit 209, pika “e”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe pikës 59, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. Prot.718 datë 19.05.2020, ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati GENTIAN METE sipas ligjit nr. 138/2015.

17. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 768/49 prot., datë 03.09.2020, ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin GENTIAN METE.

18. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit GENTIAN METE, kjo zyrë i është drejtuar më kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 713 prot, datë 19.05.2020*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr. 712 prot, datë 19.05.2020*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr. 717 prot, datë 19.05.2020*)

dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr. 715 prot, datë 19.05.2020*).

19. Gjithashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në vijim të procedurës së sipërcituar për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar **Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar** me kërkesë si institucion i njohur nga ligji lidhur me verifikimin e integritetit të kandidatëve.

20. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht *me shkresat nr.7135 prot., datë 27.07.2020 dhe nr. 2401 prot., datë 25.08.2020*.

21. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe **kontrollin e integritetit**, në zbatim të nenit 209, pika “e”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe pikës 62, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit” i kemi kërkuar Autoritetit për informim mbi dokumentet e ish sigurimit të shtetit nëse secili kandidat, sikurse tregohen në listën bashkëlidhur përfshihet në rastin e posaçëm të nenit 209, pika “e”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar: “e) *ka qenë ose jo anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991*” apo në njërin nga rastet më të përgjithshme të pikës 2 të nenit 29 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Me shkresën nr. 719 prot, datë 19.05.2020, zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati i sipërcituar, për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

22. **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit**, me shkresën nr. 489/1 prot, datë 22.06.2020, ka dërguar pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, informacionin, i cili është bashkëngjitur praktikës së kandidatit.

23. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerësoi ti drejtohet me kërkesa për informacion **Dhomës Kombëtare të Avokatisë**. Kërkesa është bërë në mbështetje të nenit 209, pika 6, gërma ”ç”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe seksionit B, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve

jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, duke kërkuar nëse kandidati, në mënyrë aktive, ka ushtruar profesionin e avokatit të paktën në dy vitet e fundit.

Dhoma Kombëtare e Avokatisë është përgjigjur me shkresën nr. Prot.154 datë 02.06.2020 (informacion i cili është administruar në dosjen e kandidatit).

24. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209, pika “e”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me shkresën me nr. Prot. 716 datë 19.05.2020 ka kërkuar informacion që lidhet me integritetin e secilit prej kandidatëve. Konkretisht është administruar informacion nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar lidhur me :

- Çdo të dhënë apo indicie të ardhur nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.

-Kopje të dokumentacionit që përmban të dhëna në rastet e identifikimit të subjektit të rivlerësimit në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale), ku përfshihen edhe biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.

Me shkresën me nr. Prot. 3648/1 datë 04.06.2020, kjo Prokurori ka dërguar informacionin e administruar në dosjen e kandidatit.

25. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 27 e vijues, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, duke vlerësuar paraprakisht se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, Komiteti ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm .

26. Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit

7

pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Komitetit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 26.10.2020, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt urdhërimin e lejimit të kandidimit të Zotit Gentian Mete, për vendin vakant për Inspektor jo magjistrat në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

II. Vlerësimi i Komitetit

27. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidimit të kandidatit GENTIAN METE për vendin vakant për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

28. Në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” ,i ndryshuar, konkretisht në nenin 209, në pikën 6, përcaktohen “Kushtet për inspektor jo magjistrat”, prej nga rezulton se:

6. Kandidatët për inspektorë, të cilët nuk janë magjistratë, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jenë shtetas shqiptarë me diplomë të nivelit të dytë në drejtësi dhe me rezultate të larta në studimet universitare;
- b) të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale;
- c) në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet;
- ç) në kohën e kandidimit, të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit të paktën 2 vitet e fundit;
- d) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- dh) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
- e) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991;
- ë) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;
- f) të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.

29. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar nga ana I.L.D.K.P.K.I-së, në zbatim të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, me shkresën nr. 171/26 prot., datë

24.07.2020, ka dërguar pranë zyrës së Inspektorit të Lartë në Drejtësi, rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin GENTIAN METE dhe personat e lidhur me të.

30. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruar nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit GENTIAN METE, I.L.D.K.P.K.I në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) nuk ka kryer deklarin të rremë;
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

31. Pra mbi bazën e verifikimeve të kryera nga organi përgjegjës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë arrin në përfundimin se hetimi i thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga I.L.D.K.P.K.I-së janë të plota dhe shteruese sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, lidhur me kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit GENTIAN METE.

32. Për këto arsye, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Komiteti vjen në përfundimin se kandidati GENTIAN METE ka “kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”. Për rrjedhojë, për sa më sipër, ky kandidat nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

33. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidati GENTIAN METE ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrjnë funksione publike”, të cilin, Inspektori i Lartë në Drejtësi ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.

34. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 768/49 prot., datë 03.09.2020, ka dërguar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin GENTIAN METE, duke ardhur në përfundimet se:

Subjekti deklarues GENTIAN METE, kandidat për Inspektor jo magjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

- a) Nuk rezultoi të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile të padeklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara.
- b) Nuk rezultoi i denuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e veprës penale, nga autoriteti gjyqësor shqiptar.
- c) Nuk rezultoi i denuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- d) Nuk rezultoi të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare për kryerjen e një veprë penale.
- e) Nuk rezultoi të ketë qenë e siguruar me ndonjë masë shtrënguese të sigurisë personale.

35. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit, Komitetivjen në përfundimin se kandidati GENTIAN METE, krahas plotësisë së saktë të formularit të vetëdeklarimit, përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “d” e nenit 209, pika 6, të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati “*ç) nuk është denuar më parë për kryerjen e një veprë penale;*”. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

36. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidati GENTIAN METE ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Komiteti ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

37. Prandaj, nisur nga vetëdeklarimi i subjektit lidhur me formularin e përcjellë për kompetencë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati GENTIAN METE, krahas plotësisë së saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara muajit korrik 1991. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 209, pika 6, gërma e) të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

38. Gjithashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ i Shtetit, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidati “*ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar*”.

Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë

ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

39. Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën nr. 2401 prot., datë 25.08.2020, ka përcjellë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, informacionin e kërkuar, të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin GENTIAN METE:

a) Nuk figurojnë të evidentuar për veprimtari kriminale.

40. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.7135 prot., datë 27.07.2020, ka përcjellë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin GENTIAN METE:

a) Nuk disponohen materiale implikuese ose kompromentuese për integritetin e figurës së Z. GENTIAN METE.

41. Shërbimi Informativ i Shtetit, me shkresën nr.1883/27 prot., datë 21.07.2020, ka përcjellë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin GENTIAN METE:

b) Nuk disponohen të dhëna dhe informacione për përfshirje në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare, apo aktivitete të kundraligjshme në ngarkim të Z. GENTIAN METE.

42. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 209, pika 6, gërma ë) të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

43. Dhoma Kombëtare e Avokatisë , me shkresën nr.154 prot., datë 02.06.2020, ka përcjellë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informacionin në lidhje me kandidatin GENTIAN METE:

a) Kandidati nuk ka ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit për dy vitet e fundit.

44. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 209, pika 6, gërma ç) të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

45. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “a”, “b”, “dh” dhe “f”, të pikës 6, të nenit 209 të ligjit nr. 115/2016, Komiteti shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidati GENTIAN METE, në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

46. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga shkronja “a” e pikës 6 të nenit 209 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të *“a) të jetë shtetas shqiptarë me diplomë të nivelit të dytë në drejtësi dhe me rezultate të larta në studimet universitare;”*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati GENTIAN METE, ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 2000 si Jurist, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Bukureshtit. Në vitin 2002 kandidati ka kryer një Master në fushën e studimeve europiane, Tiranë. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidati GENTIAN METE nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

47. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika “b” e pikës 6 të nenit 209 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati b) *të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale;* Nga aktet e administruara në fashikull, rezulton se kandidati e plotëson këtë kriter.

48. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika “c” e pikës 6 të nenit 209 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati c) *në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet;* nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë diplomën/kualifikimet, jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati GENTIAN METE ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- 1) Jurist i agjencisë “Albautor”, 2000-2003;
- 2) Specialist pranë Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve, 2003-2004;
- 3) Drejtor i departamentit Juridik “2K Group” shpk, 2004-2006;
- 4) Pedagog në Fakultetin e Drejtësisë dhe ekonomisë, Universiteti Jo publik “Kristal”, 2005-2008;
- 5) Pedagog në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Jo publik “Luarasi”, 2005-2009;
- 6) Avokat, 2008-2009;

- 7) Përgjegjës i sektorit juridik dhe prokurorimeve, Drejtoria e shërbimit të trupit diplomatik, Ministria e Punëve të Jashtme, 2009-2010;
- 8) Pedagog në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Jo publik "Akademia e Biznesit", 2011-2013;
- 9) Avokat, 2012-2017;
- 10) Pedagog në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Jo publik "Wisdom", 2013-2017;
- 11) Këshilltar Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, 2017-2020.

Lidhur me përvojën profesionale të dokumentuar, kandidati është pyetur nëpërmjet emailit të tij të ofruar si pikë kontakti, ku ka deklaruar se:

"Nga Drejtoria e Arkivit Qendror të ISSH (Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë) më janë vënë në dispozicion vërtetimet mbi bazën e vlerësuar për të gjitha vitet e punës për të cilat më janë paguar kontributet nga punëdhënësit si dhe për kontributet e likujduara nga ana ime si subjekt tatimpagues avokat, për periudhën 2000-2020. Po kështu, edhe nga DRSSH Fier më është vënë në dispozicion një vërtetim për periudhën që më janë derdhur kontributet pranë këtij institucioni. (ju lutem gjeni të skanuar të gjithë materialin me titull Vërtetime mbi Bazën e Vlerësuar 2000-2020)

Nga këto materiale, si dhe nga publikimi online në platformën ealbania konstatoj se:

- Ish punëdhënësit "Universiteti Luarasi" dhe "Universiteti Kristal" nuk kanë paguar kontribute për periudhën e punës që kam kryer si pedagog, sipas vërtetimeve që keni në dosjen time pranë jush, të lëshuara prej tyre. (ju lutem shihni dy vërtetimet përkatëse të skanuara, pjesë e materialit të përmendur më sipër) Për këto periudha kam likujduar vetë si pagesë sigurimi vullnetar të gjitha periudhat e munguara.

- Gjithashtu, në Vërtetimin mbi Bazën e Vlerësuar nr. 2165 prot, dt 06.11.2020 si dhe në platformën ealbania, konstatoj se nuk janë pasqyruar pagesat e kontributeve për muajt Tetor dhe Nëntor 2014, edhe pse pagesa për këtë periudhë është kryer prej meje nëpërmjet bankës Reiffeisen sipas procedurës. (ju lutem gjeni të skanuar të gjithë materialin me titull Pagese Kontribute tetor-dhjetor 2014). Pagesat e kontributeve kanë qenë të ndara në kuatrimestre me nga tre muaj secili, sipas njoftimit që pasqyrohej në sistemin e tatimit, të cilat likujdoheshin saktësisht nga ana ime (me sa më kujtohet, në këtë periudhë ka patur probleme me sistemin e të dhënave në organet tatimore, që janë bërë publike edhe në media). Në sistemin e të dhënave të sigurimeve shoqërore, pagesa rezulton e kryer, fakt për të cilin DRSSH Tirane ka konfirmuar me shenim si periudhë të siguruar edhe në librezën e punës (lutem gjeni të skanuar materialin me titull Libreze Pune viti 2014, ku periudha 2013-2017 nuk ka asnjë ndërprerje). Pra duket se, nga organet tatimore nuk është sistemuar dhe kontabilizuar likujdimi i detyrimit për pagesën e kontributit. Për zgjidhjen e këtij problemi i jam drejtuar me kërkesë DRT Tiranë.

Pavarësisht nga sa më sipër, konstatoj se:

Periudha e punës si jurist, për të cilën janë likujduar kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, deri në datën e aplikimit për postin e Inspektorit Jomagiistat në ILD, në konsideratë të qendrimeve të shprehura në vendimet e publikuara në lidhje me kandidatët e

tjerë, është mbi 16 vite, fakt që del edhe sipas llogaritjes që bëri në vend nëpunësja e DRSSH Tiranë (– shënim joformal i saj). (ju lutem gjeni të skanuar materialin me titull Flete perllogaritje e periudhes se punes)”

49. Bazuar në gjetjet e cituara më sipër, Këshilli konstaton se kandidati GENTIAN METE ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 6 e nenit 209 dhe shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016.

50. Në shkronjën “d” të pikës 6 të nenit 209 të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati d) *të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi*; Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë certifikatën e gjendjes gjyqësore, që është administruar në dosjen e kandidimit, Komiteti konstaton se kandidati GENTIAN METE, nuk rezulton të jetë dënuar. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

51. Në shkronjën “dh” të pikës 6 të nenit 209 të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati dh) *të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit*;

Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati GENTIAN METE, nuk rezulton të ketë mbajtur funksione politike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

52. Në shkronjën “f” të pikës 6 të nenit 209 të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati f) *të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata në kohën e kandidimit*;

Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshi këtu dhe formularin e vetëdeklarimit, rezulton se kandidati GENTIAN METE, nuk rezulton të jetë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata në kohën e kandidimit.

Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

53. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Zyra e Inspektorit të Lartë i Drejtësisë vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatit GENTIAN METE, në vendin vakant për Inspektor jo magjistrat pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.


PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 27 e vijues të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë:


VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatit GENTIAN METE, në vendin vakant për Inspektor Jo Magjistrat, Inspektor i Lartë i Drejtësisë, i shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.
2. K vendim i njoftohet kandidatit GENTIAN METE.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë , në pjesën e përcaktuar për “Rekrutim Inspektor Jo magjistrat”.

ANËTARE
Mjela KAPO



ANËTARE
Marsela PEPI



KRYETARI

Artur Hristani

